

MBROJTJA E KOSOVËS NDAJ KËRCËNIMIT TË ETHEVE HEMORRAGJIKE KRIME-KONGO: NJË PRIORITET I VAZHDUESHËM SHËNDETËSOR



Donjeta Pllana- Hajdari

Specialist i Mikrobiologjisë

Sëmundja Ethet hemorragjike Krime-Kongo (EHKK) shkaktohet nga Orthonairovirusët e Familjes Nairoviridae. Janë sëmundje zoonotike që transmetohen tek njerëzit nëpërmes të pickimit të rriqrës, kontaktit me rriqrë të infektuar ose kontaktit të drejtpërdrejtë me gjakun ose indet e kafshëve ose njerëzve të infektuar, duke e definuar edhe si transmetimin intraspitalor.

Kosova mbetet një nga zonat më të prekura nga ethet hemorragjike Krime-Kongo (EHKK) në Evropë, me një histori të gjatë të rasteve endemike dhe shpërthimeve periodike. Kjo sëmundje virale përbën një rrezik të qëndrueshëm për shëndetin publik në vend dhe më gjerë në Ballkan.

Historiku i dokumentuar i EHKK në Kosovë fillon që nga viti 1954, me cikle shpërthimesh çdo katër deri në pesë vjet dhe shpërthimi i fundit i EHKK në Kosovë ka ndodhur në vitin 2013, ku nga 26 persona të infektuar, 11 prej tyre kanë përfunduar me vdekje.

Hulumtimet e fundit kanë zbardhur shumë të panjohura lidhur me këtë sëmundje. Një studim i bërë nga një grup i profesionistëve tonë shëndetësor me bashkëpunim ndërkombëtar ka hulumtuar 32 mostra të pacientëve që janë trajtuar nga viti 2013–2016 në Klinikën Infektive të Qendrës Klinike Universitare dhe dokumentoi një shkallë alarmante vdekshmërie prej 34% mes pacientëve të prekur nga kjo sëmundje. Faktorët kryesorë që parashikojnë vdekshmërinë përfshijnë gjakderdhjen, përfshirjen neurologjike dhe ngarkesën virale shumë të lartë. Edhe pse ribavirina është përdorur si trajtim standard, rezultatet nuk kanë treguar efektshmëri të mjaftueshme, duke theksuar nevojën për terapi të reja antivirale.

Nga ana tjetër, gjenetika e virusit EHKK në Kosovë paraqet një kompleksitet të madh. Një publikim në vitin 2006 prezantoi Segmentin S të shtamit Kosova Hoti, që u depozitua në Gen Bank. Studimet filogjenetike kanë treguar se shtami kosovar është i grupuar së bashku në klade me shtamet ruse jugperëndimore dhe turke dhe filogjenetikisht ka ngjashmëri me shtamin Drosdov të EHKK.

Një tjetër hallkë kyçe e kontrollit të EHKK-së është monitorimi i vektorëve. Një analizë e rreth 800 rriqrave në Kosovë dhe Shqipëri ka konfirmuar praninë e ARN-së së virusit në *Hyalomma marginatum* dhe *Rhipicephalus bursa*. Këto të dhëna e bëjnë të qartë se kontrolli i vektorëve është thelbësor për të parandaluar përhapjen e sëmundjes.

Janë identifikuar dy linja virale: Kosova I, e lidhur me sojin AP92 dhe bartur kryesisht nga rriqrat *Hyalomma bursa*, dhe Kosova II, e izoluar nga njerëzit dhe e lidhur me *Hyalomma marginatum* dhe *Ixodes ricinus*. Kjo shumëllojshmëri sugjeron

praninë e një rezervuari viral kompleks në Kosovë, me potencial për shtame më agresive.

Nga kërkimi te veprimi

Kosova ka bërë hapa të rëndësishëm në kuptimin shkencor të EHKK-së, duke themeluar në vitin 2013 Komitetin Ndërmënyësor për Mbrojtje dhe Kontrollë nga ky patogjen, por sfidat mbeten të mëdha. Gjithashtu nga viti 2013 kemi pasur përkrahje nga Programi Gjerman për Biosiguri me aktivitete për luftimin e këtij patogjeni. Ndërsa njohuritë mbi virusin, vektorët dhe shtrirjen epidemiologjike janë zgjeruar ndjeshëm, mbetet e domosdoshme rritja e kapaciteteve për diagnostikim të shpejtë, trajtim efektiv dhe mbikëqyrje të qëndrueshme.

Në një kohë kur ndryshimet klimatike, lëvizja e kafshëve dhe globalizimi rrisin potencialin për përhapje të sëmundjeve zoonotike, Kosova duhet të jetë në vijën e parë të mbrojtjes. Investimi në kërkim shkencor, edukimi i komuniteteve rurale dhe koordinimi ndërinstitucional do të jenë themeli për të kufizuar ndikimin e EHKK-së dhe për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e qytetarëve.

Referencat:

1. Sherifi K, Cadar D, Muji S, et al. Crimean-Congo Hemorrhagic Fever Virus Clades V and VI (Europe 1 and 2) in Ticks in Kosovo, 2012. *PLoS Negl Trop Dis*. 2014;8(9):doi:10.1371/journal.pntd.0003168.
2. Ahmeti S, Berisha L, Halili B, et al. Crimean-Congo Hemorrhagic Fever, Kosovo, 2013–2016. *Emerg Infect Dis*. 2019;25(2):321–324. doi:10.3201/eid2502.171999.
3. Ajazaj-Berisha L, Halili B, Ndrejaj V, et al. Crimean-Congo Hemorrhagic Fever Mimicking HELLP Syndrome in a Pregnant woman and Her Infant in Kosovo: A Case Report. *Viruses*. 2025;17(2):178. doi:10.3390/v17020178.
4. Ahmeti S, Raka L. Crimean-Congo Haemorrhagic Fever in Kosovo: A Fatal Case Report. *Viral J*. 2006;3:85. doi:10.1186/1743-422X-3-85.
5. Taraku A, Berxholi K. Some Preliminary Results of Crimean-Congo Hemorrhagic Fever Virus among Cattle in Different Regions of Kosovo. *ANGLISTICUM J*. 2018;4:157–159.
6. Sherifi K, Rexhepi A, Berxholi K, et al. Crimean-Congo Hemorrhagic Fever Virus and *Borrelia burgdorferi* sensu lato in Ticks from Kosovo and Albania. *Front Vet Sci*. 2018;5:38. doi:10.3389/fvets.2018.00038.
7. Papa A, Božović B, Pavlidou V, et al. Genetic Detection and Isolation of Crimean-Congo Hemorrhagic Fever Virus, Kosovo, Yugoslavia. *Emerg Infect Dis*. 2002;8(8):852–854. doi:10.3201/eid0808.010448.